

Ku të drejtohem për mbrojtjen e të drejtave tona gjatë nënshkrimit të kontratave të kredive për konsum dhe në çfarë mënyre?

Në rast kur kredituesi nuk i respekton të drejtat tona të garantuara me Ligj, përkatësisht nuk na lejon të anulojmë kontratën, nuk na i siguron dhe nuk na jep të gjitha informatat e nevojshme, gjatë pagesës së parakohshme, na ngarkon provizion me përqindje më të lartë se maksimumi ligjor dhe ngjashëm, në atë situatë, varësisht nga ajo nëse kredituesi është bankë, shoqëri financiare ose shoqëri tjetër tregtare, kemi të drejtë të kërkojmë mbrojtje duke u drejtuar me shkrim pranë institucioneve kompetente si në vijim:

- Nëse kredituesi është bankë, duhet të drejtohem në Bankën Popullore të RM-së
 - Nëse kredituesi është shoqëri financiare, duhet të drejtohem në Ministrinë e financave
 - Nëse kredituesi është shoqëri tjetër tregtare, duhet të drejtohem në Inspektoratin Shtetëror të Tregut.
- Por, para se të drejtohem në institucionet kompetente, mund të këshillohem për të drejtat tona në byronë këshillëdhënëse të Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë në numrin e telefonit 02/3179-592, në postën elektronike sovetuvanja@opm.org.mk ose në hapësirat e byrosë në rr. 50 Divizija nr 10a

Çka rregullojnë ndryshimet e reja të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve gjatë kontratave të kredive për konsum nga viti 2018

Me ndryshimet më të reja të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve gjatë kontratave të kredive për konsum nga viti 2018, përfshihen edhe kreditë me shumë prej 200 euro, të cilat deri tani ishin të përjashtuara nga Ligji. Në atë mënyrë nëse vendosim të shfrytëzojmë këtë lloj të kredisë do të kemi mbrojtje juridike. Gjithashtu, me zgjidhjen ekzistuese ligjore nuk ishte e përcaktuar lartësia maksimale e shkallës vjetore e shpenzimeve të përgjithshme të kredive të konsumatorëve, me ç'rast e njëjta ndonjëherë tejkalonte edhe 200% të shumës së përgjithshme të kredisë. Me ndryshimet e reja ligjore, lartësia maksimale e shkallës vjetore e shpenzimeve të përgjithshme mund të jetë më së shumti pesë herë më e lartë se shkalla e kamatës penale ligjore në kontratat në të cilat së paku njëra palë nuk është tregtar (për momentin CBT maksimale do të ishte 55%).

Disa rekomandime për konsumatorët!

- Të vlerësojmë qëllimin tonë financiar për të cilin dëshirojmë të ngarkohemi me borxh, nëse është nevojë apo vetëm dëshirë;
- Të vlerësojmë nëse qëllimi jonë financiar mund të prolongohet (të realizohet në suaza të mundësive tona të kursimit);
- Të analizojmë mirë kapacitetin tonë familjar, përkatësisht personal për kursim dhe të mos ngarkohemi përtej atij kapaciteti;
- Asnjëherë të mos ngarkohemi me borxh tek dhënësit e palicencuar të çfarëdo lloji të kredive;
- Informatat për mundësitë për ngarkim me borxh të cilat ofrohen nga kreditues të ndryshëm dhe të vendit t'i kërkojmë në formë të shkruar dhe me vëmendje t'i lexojmë si dhe analizojmë. Sipas nevojës, të kërkojmë informatë shtesë;
- Me kujdes lexoni kontratën para se ta nënshkruani dhe kërkonit të gjitha informatat para-kontraktuese.

Për më tepër këshilla për të drejtat tuaja si konsumatorë, mund të kontaktoni Organizatën e Konsumatorëve të Maqedonisë, ZKM - Shkup, tel. 02/3 179 592 ose nëpërmjet faqes së internetit www.opm.org.mk e-mail: sovetuvanja@opm.org.mk

KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE I QYTETIT TË SHKUPIT
ME PROGRAMIN E VET E MBËSHTET MBROJTJEN E KONSUMATORËVE



KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE
I QYTETIT TË SHKUPIT
Bul. Ilinden nr. 82 - Shkup



Qyteti i Shkupit



COBET ZA ЗАШТИТА
НА ПОТРОШУВАЧИТЕ

CILAT JANË TË
DREJTAT TONA SI
KONSUMATORË
KUR NËNSHKRUAJMË
**KONTRATA TË
KREDIVE**
PËR KONSUM?

Nëpër mediat elektronike dhe të shkruara vazhdimisht publikohen reklama dhe informata për blerje të produkteve ose shfrytëzim të shërbimeve për kredi dhe si të arrijmë deri tek gjërat e dëshiruara shpejtë dhe të lehtë. Të nxitur prej mesazheve reklamuese, por edhe nga dëshirat, e ndonjëherë edhe nga nevojat tona, fillojmë të mendojmë për automjet të ri, banesë më të madhe, aparate të reja elektrike ose për pushim të mirë dhe papritmas vendosim të marrim kredi për konsum.

Ndërkohë nuk i kemi kontrolluar të gjitha kushtet nën të cilat ofrohen kreditë për konsum, nuk kemi pasur kohë të analizojmë se cila nga ofertat përshtatet na më së shumti, sa do të jetë kësti për pagesë, si dhe vlerësim për atë se sa kredia do të ngarkojë buxhetin tonë familjar dhe personal.

Çka është “kontrata e kredisë për konsum”?

Është kontratë ose pajtim të vullneteve, me të cilën kredidhënësi miraton për ne kredi në formë të huas, pagesë e prolonguar të produkteve dhe shërbimeve dhe shërbime tjera të ngjashme financiare.

Për çka na shërben kredia për konsum?

Kredia për konsum mund të na shërbejë për financim të nevojave aktuale, udhëtimeve turistike si dhe për blerje të të mirave permanente të harxhueshme, për shembull: automjet, frigorifer, koftor, televizor, smartfon, thithëse ose të mallra tjera.

A është kredituesi i obliguar ta vlerësojë aftësinë tonë kredituese?

- Para nënshkrimit të kontratës së kredisë për konsum, kredituesi duhet ta vlerësojë aftësinë tonë kredituese në bazë të informatave që i pranon prej nesh dhe nga baza relevante të të dhënave;
- Më tej, kredituesi e ka për obligim para nënshkrimit të kontratës për kredi të na jep sqarime për të gjitha rrethanat relevante në lidhje me kontratën e kredisë për konsum duke i vlerësuar nevojat dhe gjendjen tonë financiare;
- Kredituesi i ka këto obligime edhe në rast komunikimi me telefon ose me mjet tjetër të audio komunikimit.

Cilat informata para-kontraktuese është i detyruar të na i jep kredituesi?

Para se të nënshkruajmë kontratë të kredisë për konsum, kredituesi duhet të na i sigurojë informatat para-kontraktuese në vijim: lloji i kredisë, emri dhe mbiemri, përkatësisht emri dhe adresa e kredituesit, shuma e përgjithshme e kredisë dhe kushtet për shfrytëzimin e të njëjtit, kohëzgjatja e kontratës së kredisë, norma e interesit, shkalla vjetore e shpenzimeve të përgjithshme dhe shuma e përgjithshme që duhet të paguhet nëpërmjet ekzemplarit reprezentativ në të cilin janë përmendur të gjitha supozimet për përllogaritje të shkallës vjetore të shpenzimeve të përgjithshme, shuma e secilit këst veç-e-veç dhe numri i kësteve, ekzistim të shpenzimeve noteriale që duhet t'i paguajmë gjatë nënshkrimit të kontratës, norma e interesit që aplikohet në rast të pagesave me vonesë dhe shpenzime për mospërbushje të obligimit, paralajmërim për pasojat nga mospagesa e kësteve, garancitë për kredinë, e drejta për informim falas për aftësinë tonë kredituese, e drejta për të ftuar kopje falas të draft-kontratës së kredisë për konsum, si dhe afat në të cilin kredituesi është i obliguar me informatat para-kontraktuese.

Cilat janë obligimet tona gjatë nënshkrimit të kontratës së kredisë për konsum?

Gjatë nënshkrimit të kontratës së kredisë për konsum, ne jemi të obliguar të paguajmë kompensime për kredituesin (anuitete ose këste). Ndër këto kompensime bazike është kamata që paraqet kompensim për përdorim të mjeteve.

Çka duhet të përmbajë kontrata e kredisë për konsum?

Kontrata e kredisë për konsum të cilën e nënshkruajmë me kredituesin, duhet t'i përmbajë këto informata: 1) lloji i kredisë; 2) emri dhe mbiemri jonë, përkatësisht emri dhe zyra e kredituesit; 3) kohëzgjatja e kontratës; 4) shuma përgjithshme e kredisë dhe kushte për shfrytëzim të të njëjtit; 5) vlera e mallit ose shërbimit të caktuar nëse kredia përdoret për pagesë të tyre; 6) lartësia e normës së interesit; 7) shkalla vjetore e shpenzimeve të përgjithshme dhe i shumës së përgjithshme që duhet ta paguajmë; 8) shuma e secilit këst veç-e-veç, numri i kësteve dhe maturimi i tyre; 9) informata për të drejtën për raport lidhur me llogarinë në formë të planit amortizues; 10) periudha dhe kushtet për pagesë të kamatës dhe shpenzimeve, nëse paguhet ma pagesë të borxhit kryesor;

11) informata për obligimin tonë për nënshkrim të kontratës për sigurim ose marrëveshje tjetër plotësuese, nëse është kusht për të marrë kredinë; 12) kamatë penale gjatë nënshkrimit të kontratës së kredisë për konsum; 13) paralajmërim për pasojat nga mospagesa e kësteve; 14) informata për të drejtën e anulimit të kontratës së kredisë për konsum; 15) informata për të drejtën e pagesës së parakohshme të kredisë dhe informata tjera.

A mund të tërhiqemi nga kontrata e kredisë për konsum?

Ne si konsumatorë kemi të drejtë të tërhiqemi nga kontrata e kredisë për konsum në afat prej 14 ditësh pa paraqitur arsye për anulimin, kurse afati i anulimit fillon të rrjedh nga:

- dita e nënshkrimit të kontratës ose;
- nga dita kur konsumatori i ka pranuar kushtet dhe informatat nga kontrata nëse ajo ditë është më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës.

A mund ta paguajmë kredinë para kohe?

Në pajtim me kontratën për kredi, atë mund ta paguajmë në çdo kohë, krejtësisht apo pjesërisht, pjesën e mbetur të kredisë pa shpenzime shtesë. Në atë rast kemi të drejtë të zvogëlim të shpenzimeve të përgjithshme të kredisë, që përbëhet nga kamata dhe shpenzimet tjera për periudhën e mbetur të kohëzgjatjes së kontratës për kredi. Megjithatë, kredituesi ka të drejtë të arkëtojë kompensim në formë të provizionit për shkak të pagesës së parakohshme. Kompensimi i tillë nuk guxon të tejkalojë 1% të shumës së kredisë së paguar para kohe, nëse periudha ndërmjet pagesës së parakohshme dhe kohëzgjatjes së kontratës së kredisë nënshkruhet në periudhë më të gjatë se një vit nga afati i kohëzgjatjes së kontratës së kredisë, përkatësisht jo më tepër se 0.5%, nëse pagesa e parakohshme ndodh në periudhë jo më të gjatë se një vit nga periudha e kohëzgjatjes së kontratës së kredisë. Por, me përjashtim kredituesi, nuk ka të drejtë arkëtimit të kompensimit nëse:

- pagesa e parakohshme është bërë në bazë të kontratës për sigurim të nënshkruar si garanci për pagesë të kredisë;
- në rast tejkallimit të lejuar ose
- pagesa e parakohshme bëhet në kohë kur norma e interesit nuk është fikse.